



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Të dhënat shtesë për Studimin e Fizibilitetit

Shtator 2012

Hyrje

Pas konkluzioneve të Këshillit të çështjeve të përgjithshme me 28 Shkurt të vitit 2012 i cili mori parasysh qëllimin e këshillit për të nisur Studimin e Fizibilitetit për Marrëveshjen mes Bashkimit Evropian dhe Republikës së Kosovës me 7 Maj ka pranuar pyetëtorin për përgatitjen e Studimit të Fizibilitetit për Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit. Një pjesë shtesë e pyetjeve është dërguar me 18 Maj të vitit 2012

Më 8 Qershor 2012, Qeveria ka dorëzuar përgjigjet e pyetësorit tek Komisioni Evropian.

Përgjatë 18 - 22 Qershorit të vitit 2012, misioni i KE-së për gjetjen e fakteve ka vizituar Kosovën.

Ky raport përfaqëson versionin përfundimtar të përditësuar të Qeverisë së Kosovës i cili përfshin progresin e bërë në periudhën në mes të fillimit të Qershorit deri në mes të Gushtit. Ky kontribut është organizuar në përputhje me strukturën e Studimit të Fizibilitetit.

Tabela e Përmbajtjes

Kriteret Politike.....	5
1.1. Demokracia dhe Sundimi i Ligjit.....	5
1.1.1. Legjislatura.....	5
1.1.2. Ekzekutivi dhe Presidenti.....	5
1.1.3. Administrata Publike..	6
1.1.4. Reformat në sektorin e bujqësisë.....	7
1.1.5. Sistemi gjyqësor.....	7
1.1.6. Lufta kundër korrupsionit.....	8
1.1.7. Marrëdhëniet me bashkësinë ndërkombëtare.....	9
1.2. Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e pakicave.....	9
1.2.1. Të drejtat civile dhe politike.....	9
1.2.2. Të drejtat ekonomike dhe sociale.....	9
1.2.3. Respektimi për të drejtat kulturore dhe mbrojtja e minoriteteve.....	11
2. Kriteret Ekonomike.....	13
2.1. Të dhënat makro-ekonomike.....	13
2.2. Të dhënat ekonomiko-sociale.....	13
2.3. Treguesit Strukturalor.....	13
2.4. Procesi i negociimit të pagave dhe sistemi i sigurimeve shoqëror.....	13
2.5. Zhvillimit dhe reformat strukturale dhe ekonomike.....	13
2.6. Raporti mbi politikat monetare fiskale.....	15
2.7. Funksionimi i tregjeve të produktit.....	16
2.8. Tregjet Financiare.....	18
2.8.1. Sektori Bankar.....	18
2.8.2. Sektori Jo-Bankar.....	18
3. AFTËSIA PËR TË PËRBALLUAR DETYRIMET QË RRJEDHIN NGA MSA	19
3.1. Dialogu politik	19
3.2. Bashkëpunimi Rajonal.....	19
3.3. Lëvizja e Lirë e Mallrave dhe e Kapitalit	19
3.4. Lëvizja e Njerëzve, shërbimeve dhe e drejta e themelimit.....	21
3.4.1. Lëvizja e Njerëzve.....	21
3.4.2. Lëvizja e Shërbimeve.....	21
3.4.3. Mbrojtja e Konsumatorëve.....	23
3.4.4. Tregtia	23
3.4.5. Ligji i kompanive.....	23
3.4.6. Tregtia në Shërbime	23
3.5. Konkurrenca	24
3.6. Të drejtat mbi pronësinë intelektuale, industriale dhe komerciale	24
3.6.1. Të drejtat mbi pronësinë industriale.....	24
3.7. Prokurimi Publik.....	24

3.8.	Drejtësia dhe Çështjet e Brendshme.....	25
3.8.1.	Fuqizimi i institucioneve dhe sundimi i ligjit.....	25
3.8.2.	Azili, migracioni, kontrollimi i kufijve/kufijve administrativ dhe çështja e vizave	25
3.8.3.	Lufta kundër pastrimit të parave.....	26
3.8.4.	Parandalimi dhe luftimi i krimit të organizuar dhe aktivitetet tjera Kriminale, duke përfshirë terrorizmin.....	26
3.9.	Politikat e bashkëpunimit	27
3.9.1.	Statistikat	27
3.9.2.	Nxitja dhe mbrojtja e investimeve, bashkëpunimi industrial, Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) dhe turizmi.....	30
3.9.3.	Bujqësia dhe sektori agro-industrial	30
3.9.4.	Doganat dhe Tatimet	33
3.9.5.	Punësimi, politika sociale, politika e shëndetit publik, edukimi dhe trajnimi, hulumtimi i teknologjisë dhe inovacioni.....	34
3.9.6.	Kultura, audio-vizuale, telekomunikacioni dhe shërbimet postare dhe shoqëria informative.....	39
3.9.7.	Transporti	40
3.9.8.	Energjia, përfshirë sigurinë bërthamore.....	43
3.9.9.	Mjedisi dhe Ndryshimet klimatike.....	43
4.	ANEKI I- LISTA E LIGJEVE TË MIRATUARA GJATË PERIUDHËS QERSHOR-SHTATOR 2012	43
5.	ANEKSI I AKTEVE NËN-LIGJORE TË MIRATUARA NGA QEVERIA DHE MINISTRITË (QERSHOR - GUSHT 2012)	44

KRITERET POLITIKE

1.1. Demokracia dhe Sundimi i Ligjit

1.1.1. Legjislatura

Përgjatë kësaj periudhe, një numër prej 20 projekt ligjeve është miratuar nga Qeveria. Në lidhje me aktet nënligjore, një numër prej 15 akteve janë miratuar, 7 Rregullore si dhe 8 UA. Zyra Administrative në Mitrovicën Veriore është themeluar më 23.05.2012 përmes një vendimit të qeverisë nr. 01/75. Me qëllim të funksionalizimit të kësaj zyre, MAPL-ja bashkë me Ministrinë e Financave dhe Komunën e Mitrovicës ka ndarë buxhetin për Zyrën Administrative të Mitrovicës veriore me anë të rishikimit të buxhetit 2012, duke bërë ZAMV-në njësinë e re organizative buxhetore me buxhetin e vet. Për më tepër MAPL-ja ka shpallur konkurs pune për 55 pozicione themelore për të kryer detyrat dhe përgjegjësitë e zyrës. Krye-shefi ekzekutiv, zëvendësi i tij, 7 Drejtorë dhe 43 zyrtarë të tjerë janë rekrutuar deri tani, duke përbërë kështu një numër prej 52 të punësuarve.

Gjithashtu, më 31.08.2012 Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar në parim projekt ligjin për ndryshimin e ligjeve që lidhen me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës.

Për më tepër, MAPL-ja së bashku me ICO dhe projektin USAID/ DEMI kanë zhvilluar planin për ngritjen e kapaciteteve për zyrën administrative të Mitrovicës veriore dhe deri më tani kanë organizuar 13 trajnime.

1.1.2. Ekzekutivi dhe Presidenti

Në bazë të vendimit të Presidentit të Republikës së Kosovës, KQZ-ja ka organizuar zgjedhje të jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës në Ferizaj më 29.04.2012 me raundin e dytë më 27.05.2012, ndërsa zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetarin e Kaçanikut janë organizuar më 17.06.2012.

Rezultatet për raundin e parë të zgjedhjeve në Ferizaj janë certifikuar më 04.05.2012, dhe 01.06.2012 për raundin e dytë, ndërsa rezultatet e zgjedhjeve në Kaçanik janë certifikuar më 26.06.2012.

Përgjatë periudhës Qershor-Korrik, KQZ-ja ka rekrutuar dy zyrtarë për pozitën e Auditimit të Brendshëm më 01.06.2012 dhe një Zyrtar të Latë për Buxhet dhe Financa më 01.06.2012.

1.1.3. Administrata Publike

Aktet nënligjore të miratuara janë:

- Rregullorja Nr. 13/2012 në pensionimin e parakohshëm të nëpunësve civilë më 28.06.2012;
- Rregullorja për vlerësimin e rezultateve të nëpunësve civil në Kosovë, më 17.08.2012;

Më 04.07.2012, Qeveria e Republikës së Kosovës me vendimin nr. 05/82 ka miratuar organizimin dhe funksionimin e strukturave për zbatimin e Planit të Veprimit të Strategjisë së Reformës së Administratës Publike.

Më 11.07.2012 Qeveria ka miratuar Vendimin nr. 05/83 për themelimin e Planifikimit të Strategjisë së Grupit Drejtues i cili përbëhet nga përfaqësues të ZK-së, MF-së, dhe MIE.

Dokumentet strategjike Plani Vjetor për vitin 2012 është shqyrtuar nga Zyra për Planifikim Strategjik, në bashkëpunim me të gjitha ministritë. Plani i ndryshuar është miratuar nga Qeveria më 01.08.2012 me Vendimin nr. 05/85.

Mbledhjet e mëposhtme të nën-grupeve për Reformë në Administratën Publike janë mbajtur:

- 06.08.2012, mbledhja e parë e nën-grupit për „Prokurim Publik“, e ftuar dhe kryesuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
- 07.08.2012, mbledhja e parë e nën-grupit për „Organizimin e Administratës Publike“, e ftuar dhe kryesuar nga Departamenti për Menaxhimin e Reformës së Administratës Publike;
- 10.08.2012, mbledhja e parë e nën-grupit për „Menaxhimin dhe Zhvillimin e Burimeve Njerëzore“, e ftuar dhe kryesuar nga Departamenti për Administrim të Shërbimit Civil, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal;
- 16.08.2012, mbledhja e parë e nën-grupit për „Kontroll dhe Auditim të Brendshëm“, e ftuar dhe kryesuar nga Njësia Qendrore e Harmonizimit për Auditim të Brendshëm.

Më 11.08.2012 Komisioni Ndërmnistror për Administratë Publike ka mbajtur një mbledhje dhe ka miratuar Planin Zhvillimor Strategjik të Ministrisë së Diasporës me vendimin nr. 970/12 si dhe Ministria e Tregtisë dhe Industrisë me vendimin nr. 969/12.

Gjatë periudhës nga data 01.06 - 17.08.2012, Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP) ka organizuar 16 kurse trajnimi në fushat në vijim: menaxhim, administrim, legjislacion, burime njerëzore, çështje të BE-së dhe çështje komunale.

Treguesit e rezultateve për të gjitha kurset e trajnimit për këtë periudhë janë paraqitur në shifrat e mëposhtme: 564 nëpunës civil janë trajnuar përmes 16 kurseve trajnuese të mbajtura në 71 ditët e trajnimit me 33 grupe të pjesëmarrësve. Treguesit gjinor: 53.36% ishin meshkuj dhe 46.45% femra. 11 pjesëmarrës ishin nëpunës civil të cilët si gjuhë amtare kanë gjuhën serbe.

Në vijim është struktura e pjesëmarrësve:

- 30 pjesëmarrës ishin nga niveli i lartë menaxherial;
- 202 pjesëmarrës nga niveli menaxherial;
- 303 pjesëmarrës nga niveli profesional;
- 31 pjesëmarrës nga niveli administrativ.

1.1.4. Reformat në Sektorin e Sigurisë

Nuk ka zhvillime të regjistruara përgjatë periudhës së raportimit.

1.1.5. Sistemi gjyqësor

Kuvendi ka miratuar Kodin Penal, (Nr. 04/L-082), ndërsa më 19.06.2012 Kuvendi ka miratuar Ligjin mbi Detyrimet nr. 04/L-077.

Gjatë periudhës së raportimit KPK-ja ka miratuar legjislacionin dytësor në vijim:

- Rregulloren për procesin e emërimit të prokurorëve më 04.07.2012;
- Rregulloren për caktimin dhe transferimin e stafit mbështetës më 10.08.2012;
- Kodin e Etikës për anëtarët e Këshillit Prokurorial të Kosovës më 31.07.2012;
- Kodi i Etikës për Prokurorët më 31.07.2012;
- Kodi i Etikës për stafin mbështetës në Sistemin Prokurorial në Kosovë më 31.07.2012.

Me qëllim të procesit të rekrutimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve më 31.07.2012, KPK-ja ka themeluar panelin për emërimin e kandidatëve për prokurorë në të gjitha Gjykatat e Qarkut dhe ato Komunale.

Sa i përket aktiviteteve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), përgjatë periudhës raportuese KGJK-ja ka emëruar 44 gjyqtarë për Gjykatat Komunale. Gjithashtu, duke synuar drejt procesit të emërimit KGJK-ja ka përcjellë në Zyrën e Presidentes për dekretim 43 gjykatës për Gjykatat Komunale për Kundërvajtje.

Ministria e Drejtësisë (MD) ka themeluar inspektoratin për mbikëqyrjen e performancës së Shërbimit Korrektues të Kosovës. Për më tepër, SHKK-ja në Mars të vitit 2012 ka themeluar një data bazë e cila përfshin të dhëna mbi të burgosurit.

Në fushën e bashkëpunimit gjyqësor në çështjet penale, MD-ja ka përpunuar 1,603 raste, nga të cilat 380 janë kërkesa të reja. 3 persona janë ekstraduar në Republikën e Kosovës.

Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të gjyqësorit, gjatë periudhës raportuese, KGJK-ja ka organizuar 7 trajnime të specializuara për 60 gjyqtarë, 29 prokurorë dhe 35 të tjerë.

1.1.6. Lufta kundër korrupsionit

Sa i përket aktiviteteve të Agjencisë Kundër Korrupsionit, agjencia në bashkëpunim me Policinë, Prokurorinë/Këshillin Prokurorial të Kosovës, Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Administratën Tatimore të Kosovës dhe Doganat në Qershor ka publikuar një raport me të gjitha të dhënat mbi prokurorinë dhe gjykimin e rasteve të korrupsionit në Kosovë që nga viti 2011. Raporte të ngjashme të përbashkëta me të dhënat statistikore për vitin 2011 janë finalizuar dhe priten të publikohen.

Në Qershor AKK-ja ka filluar procesin e konfirmimit të deklaramit të pasurisë nga zyrtarët e lartë publik, duke publikuar në të njëjtën kohë deklaratat e pasurisë së 3656 zyrtarëve të lartë publik – një rritje prej 1830 krahasuar me vitin e kaluar. AKK-ja ka iniciuar procedura penale për 261 zyrtarë të lartë publik, të cilën kanë dështuar ti përmbahen kërkesave të AKK-së në deklaramin e pasurive të tyre.

AKK-ja ka raportuar 22 raste të mundshme të konfliktit të interesave të cilat janë nën hetim; 11 raste të cilat janë zgjidhur dhe 3 mendime të cilat tashmë janë lëshuar.

Në fushën e luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, më 16 Korrik 2012 Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka marrë vendim për trajtimin e rasteve me prioritet, kurse KPK-ja më 20.07.2012 ka emëruar koordinatorët përgjegjës.

Agjencia për Menaxhimin e Pasurive të Konfiskuara gjatë periudhës raportuese ka pranuar 58 raste nga gjykatat, zyrtarët e prokurorisë dhe institucionet tjera përkatëse në konfiskimin dhe sekuestrimin e aseteve, nga të cilat 31 raste janë ekzekutuar. Vlera e përafërt e pasurisë së konfiskuar, e cila administrohet nga Agjencia është rreth 1,100,000.00 €.

Në lidhje me rritjen e ndërgjegjësimit mbi korrupsionin, AKK-ja në bashkëpunim me EULEX-in ka nisur një fushatë ndërgjegjësimi.

1.1.7. Marrëdhëniet me bashkësinë ndërkombëtare

Nuk ka zhvillime të regjistruara përgjatë periudhës së raportimit.

1.2. Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e pakicave

Ligji për Personat e Verbër nr. 04/L-092 është miratuar më 14.06.2012 dhe shpallur nga Presidenti i Republikës së Kosovës më 02.07.2012, Dekreti nr. DL-032 -2012.

1.2.1. Të drejtat civile dhe politike

Rregullorja e Punës së Komisionit Qeveritar për Personat e Pagjetur u miratua më 04.07.2012.

Gjatë tremujorit të fundit, aktivitetet që lidhen me gërmimet, zhvarrosjen e eshtrave, duke përfshirë rastet e vërtetimit të identitetit, kanë sjellë në përfundim 10 raste gjithsej. Gërmimet janë kryer në pjesë të ndryshme si Pejë, Fushë-Kosovë, Mitrovicë, Pastasel-Rahovec, Syriganë-Skenderaj, Abri-Gllogovc, Prekaz-Skenderaj dhe Zhilivodë-Vushtrri.

Duhet të theksohet që gërmimet e kryera në fshatin Zhilivodë-të komunës së Vushtrrisë, janë iniciuar dhe realizuar në përgjigje të kërkesës së Komisionit Qeveritar të Serbisë për Personat e Zhdukur. Procesi ka filluar më 31.08.2010 dhe ka përfshirë Forcat e Sigurisë së Kosovës në koordinim me ekspertë të EULEX-it dhe ekspertë kombëtarë nga Departamenti i Mjekësisë Ligjore (DML) si dhe me mbështetjen e plotë të Komisionit Qeveritar për Personat e Zhdukur (KQPZH) të Republikës së Kosovës, Komunës së Vushtrrisë si dhe Policisë së Kosovës ku më 02.08.2012 gërmimet në këtë zonë janë përfunduar zyrtarisht.

Ndër të dhënat e paraqitura më lart, në lidhje me respektimin e të drejtave të njeriut në kontekstin e bashkëpunimit rajonal dhe detyrimeve ndërkombëtare, më 05.07.2012 mbetjet e 4 personave (etnitetit serb) iu dorëzuan Komisionit Qeveritar të Serbisë për Personat e Zhdukur, si dhe më 06.07.2012 në Prizren, mbetjet e 3 personave të identifikuar të përkatësisë etnike serbe janë dorëzuar tek familjet e tyre.

Në fushën e barazisë gjinore dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, Qeveria e Republikës së Kosovës më 11.07.2012 ka miratuar vendimin nr. 04/83, ku ka emëruar Koordinatorin Kombëtar kundër Dhunës në Familje (Zëvendësministri i Drejtësisë).

Agjencia për Barazi Gjinore së bashku me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale kanë organizuar trajnime për 180 punonjës socialë në pesë komuna: Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Prizren dhe Gjilan.

1.2.1.1. E drejta për gjykim të drejtë / Qasja në drejtësi

Nuk ka zhvillime të regjistruara përgjatë periudhës së raportimit.

1.2.1.2. Liria e shprehjes

Nuk ka zhvillime të regjistruara përgjatë periudhës së raportimit.

1.2.1.3. Liria e mbledhjes dhe e organizimit

Nuk ka zhvillime të regjistruara përgjatë periudhës së raportimit.

1.2.1.4. Liria e mendimit, ndërgjegjes, dhe fesë

Nuk ka zhvillime të regjistruara përgjatë periudhës së raportimit.

1.2.1.5 Mbrojtja e të dhënave personale

Nuk ka zhvillime të regjistruara përgjatë periudhës së raportimit.

1.2.2. Të drejtat ekonomike dhe sociale

a. Të drejtat pronësore

Agjencia ka pranuar 42,093 kërkesa nga të cilat 37,349 ose 88.7% kanë qenë për tokë bujqësore; 3,786 ose 9% për prona rezidenciale dhe 958 ose 2.3% për prona tregtare. Të gjitha kërkesat janë publikuar, prej të cilave 41,363 prona kanë marrë njoftimin dhe për 41,017 është bërë verifikimi i dokumenteve të kërkesës.

Deri më tani, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK) ka shqyrtuar 31,527 kërkesa ndërsa të tjerat (10,566) janë në fazat e hershme të procesit të gjyimit.

Progresi i arritur nga Agjencia Kosovare e Pronës për periudhën raportuese Qershor 2012-Gusht 2012 është si vijon:

- 248 prona janë identifikuar dhe njoftimet publike janë dhënë në mënyrë që kërkesat eventuale ose kërkesat për ato prona janë dorëzuar;
- Dokumentacioni është verifikuar për 595 prona;
- Komisioni për Kërkesa Pronësore ka mbajtur një seancë gjatë periudhës raportuese, ku nga 1822 kërkesa mbi të cilat është vendosur dhe nga 31 ankesa të cilat janë pranuar kundër vendimeve të marra nga Komisioni; 3465 njoftime rreth vendimeve u janë shpërndarë palëve (që të dyja palëve);
- 1,188 vendime janë implementuar përmes ri-posedimit të pronës; menaxhimit, mbylljes së rastit me kërkesë të palës ose subjektit të mbylljes për shkak të mos

bashkëpunimit të aplikuesit (nëse periudha e paraparë për të kërkuar zbatimin e vendimit, ka skaduar);

- 839 prona janë marrë nën administrim (kryesisht tokë bujqësore) me kërkesë të pronarit duke ndjekur vendimin përfundimtar të Komisionit;
- Gjatë zbatimit të skemës së qiradhënies për këtë periudhë janë mbledhur 134,268.47 Euro, nga të cilat 34.918.52 Euro u janë paguar pronarëve;
- 586 dëbime janë kryer nga të cilat 191 janë kryer me dëbim fizik dhe se: 31 dëbime kanë të bëjnë me kërkesa nga paditësi për ri posedim dhe 160 dëbime për shkak të mos pagesës së qirasë. Ndërsa 395 dëbime janë anuluar pasi që banuesi para datës së dëbimit ka paguar qiranë;
- Gjithsej 1188 raste janë përfunduar.

1.2.3. Respektimi për të drejtat kulturore dhe mbrojtja e minoriteteve

Për qëllim të stabilizimit dhe qëndrueshmërisë socio-ekonomike të komuniteteve pakicë në Kosovë, komiteti i projektit “ Stabilizimi dhe Ri-integrimi i Komuniteteve” ka përzgjedhur 29 përfitues nga bizneset e vogla në 5 komuna: Klinë, Prizren, Shterpce, Istog, dhe Rahovec.

Gjatë periudhës raportuese 20 projekte të OJQ-ve janë mbështetur, me një shumë prej 63,700.33€ e cila është në funksion të drejtpërdrejtë të procesit të kthimit ,ri-integrimit, dhe stabilizimit të komuniteteve. Për më tepër, materiali për ndërtim i është ofruar 176 familjeve me një shumë prej 1,586,763.47€.

Sa i përket përmirësimit të kuadrit institucional në fushën e mbrojtjes së pakicave në nivel komunal, procesi i krijimit të Zyrave Komunale për Komunitete dhe Kthim ka përfunduar gjithashtu edhe në komunat e reja, duke rezultuar në punësimin e një zyrtari në komunën e Mamushës dhe një në komunën e Graçanicës. Gjithashtu Zyrat për Koordinim Rajonal janë krijuar: Zyra Rajonale në Pejë me 5 zyrtarë, Zyra Rajonale në Prizren me 3 zyrtarë, Zyra Rajonale në Gjilan me 1 zyrtarë, Zyra Rajonale në Ferizaj me 1 zyrtar dhe Zyra Rajonale në Mitrovicë me 2 zyrtarë.

1.2.3.1. Institucionet/Përfaqësimi

Nuk ka zhvillime të regjistruara përgjatë periudhës së raportimit.

1.2.3.2. Qasja në Edukim

Nuk ka zhvillime të regjistruara përgjatë periudhës së raportimit.

1.2.3.3. Gjuhët Zyrtare

Nuk ka zhvillime të regjistruara përgjatë periudhës së raportimit.

1.2.3.4. Mediat e Minoriteteve

Nuk ka zhvillime të regjistruara përgjatë periudhës së raportimit.

1.2.3.5. Romë, Ashkali dhe Egjiptian

Nuk ka zhvillime të regjistruara përgjatë periudhës së raportimit

1.2.3.6. Refugjatët dhe të Zhvendosurit Brenda Vendit

Me qëllim të përmirësimit të kushteve për kthim dhe ri-integrim të qëndrueshëm të PZH-ve (Personave të Zhvendosur) dhe PZHBV (Personat e Zhvendosur Brenda Vendit), Komisioni Qendror për Shqyrtim ka bërë identifikimin dhe përzgjedhjen e 282 përfituesve potencial të cilëve do të u ndërtohen shtëpitë gjatë vitit 2012, duke mbuluar të gjitha rajonet e Kosovës. Ndërtimi i 60 shtëpive për të kthyerit ka filluar dhe deri më tani janë ndërtuar 9 shtëpi dhe u janë dorëzuar përfituesve. Për më tepër, MKK-ja ka financuar ndërtimin e rrugës në fshatin Vitomicë, të komunës së Pejës me një vlerë prej 114,000.00 euro.

1.2.3.7. Të drejtat kulturore duke përfshirë trashëgiminë kulturore

Sa i përket përmirësimit të kuadrit ligjor në fushën e të drejtave kulturore, Ligji për Teatrin nr. 04/L-106 është miratuar më 03 Korrik 2012.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve më 15.08.2012 ka miratuar Kornizën e Vendimit nr. 1804/2012 mbi themelimin e çmimeve për Kinematografi.

2. KRITERI EKONOMIK

2.1. Të dhënat makro-ekonomike

Nuk ka zhvillime të regjistruara përgjatë periudhës së raportimit.

2.2. Të dhënat ekonomiko-sociale

Nuk ka zhvillime të regjistruara përgjatë periudhës së raportimit.

2.3. Treguesit Strukturore

Nuk ka zhvillime të regjistruara përgjatë periudhës së raportimit.

2.4. Procesi i negocimit të pagave dhe sistemi i sigurimeve shoqëror

Nuk ka zhvillime të regjistruara përgjatë periudhës së raportimit.

2.5. Zhvillimit dhe reformat strukturale dhe ekonomike

Ligji i Buxhetit Nr. 04/L-079 është ndryshuar dhe plotësuar nga ana e Kuvendit më 12.07.2012, në bazë të udhëzimit të lëshuar nga Ministria e Financave.

Një marrëveshje për bashkëpunim financiar është nënshkruar me qeverinë e Austrisë këtë Gusht. Ministria e Financave të Austrisë do të mbështet zhvillimin dhe financimin e projekteve të infrastrukturës në Kosovë në kuadër të programit të kredive të buta të ri-financuara nga Banka Austriake.

Banka Qendrore e Kosovës ka shqyrtuar të dhënat e bilancit të pagesave që nga viti 2009. Si rezultat, Enti Statistikor do të publikojë statistikat e llogarive kombëtare deri në fund të Shtatorit të këtij viti.

Sipas statistikave të importit, që nga Qershori i vitit 2012, konsumimi privat është rritur me një vlerë reale prej 3.8% ndërsa investimet e përgjithshme janë rritur me 7% në terma realë. Eksportimi i mallrave ka pësuar një rënie të ndjeshme prej 20% në terma realë, kurse importi i mallrave është rritur me një vlerë reale prej 4.6%. Rënia e eksporteve atribuohet me rënien e çmimit të metaleve në tregje. Edhe pse, eksportet e produkteve të tjera janë rritur, një rritje e tillë ishte e pamjaftueshme për të kompensuar për shkak të rënies së eksporteve të metalit duke u bazuar në shkallën e ultë të bazës së eksporteve.

Të ardhurat buxhetore dhe shpenzimet e përgjithshme janë rritur gjatë kësaj periudhe me 12% dhe 18.5% respektivisht.

Statistikat në dispozicion rreth Investimeve të Huaja Direkte për tremujorin e parë të vitit 2012 tregojnë një rënie prej 27.4% të IHD-ve. Megjithatë, këto të dhëna nuk reflektojnë realisht trendin e IHD-ve për shkak të ndikimit sezonal të dimrit të ashpër në disa muajt e parë të vitit.

Sa i përket inflacionit, niveli mesatar i çmimeve është rritur për 1.4% përgjatë periudhës Janar-Qershor 2012. Gjatë kësaj periudhe, çmimet e ushqimeve kanë rënë për 1.7% mesatarisht, kryesisht si rezultat i rënies së çmimit të grurit dhe të miellit. Çmimet e karburantit janë rritur për 2.6% mesatarisht në tremujorin e parë, pasuar nga një rënie e mëvonshme prej 3.4% në tremujorin e dytë të vitit 2012. Çmimet e komunikimit duke përfshirë ato postare dhe shërbimet telefonike kanë rënë për 3.6% krahasuar me vitin e kaluar.

Ndërhyrjet e Qeverisë në Ekonomi

a. Privatizimi i Distribuimit dhe Furnizimit me Energji Elektrike (KEDS)

Komisioni për vlerësimin e ofertave më 8 Qershor ka hapur ofertat financiare në një sesion publik. Dy kompani kanë dorëzuar ofertat e tyre financiare: Konsorciumi Calik – Limak me 26.3 milion euro, dhe Elsewedy 22.8 milion euro. Oferta përfundimtare fituese është dhënë për Konsorciumin Limak-Calik

Më 12 Qershor 2012, Komisioni Qeveritar i Privatizimit ka shqyrtuar dhe miratuar ofertën e Konsorciumit Limak-Calik me një vlerë prej 26.3 milion euro si kompani e preferuar.

Nënshkrimi i marrëveshjes së biznesit dhe përmbushjes së kushteve duhet të bëhet brenda 90 ditë pune nga shpallja zyrtare e autoriteti kontraktues jo më vonë se 19 Tetor 2012.

b. Privatizimi i PTK-së

Ftesa për para kualifikimin e investitorëve potencialë është shpallur më 25 Qershor 2012. Kriteret financiare dhe teknike janë dizajnuar në atë mënyrë që të mundësojnë konkurrencën e duhur për procesin, dhe të mundësojnë kualifikimin e kompanive me përvojë në sektorin e telekomit që janë të afta për zhvillimin e mëtejshëm të PTK-së.

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave për para-kualifikim ishte 13 Gusht dhe kompanitë në vijim kanë dorëzuar aplikacionet e tyre: Albright Capital Management

LLC (SHBA); Avicenna Capital LLC në konsorcium me Twelve HORNBEAMS (UK, Poloni); Columbia Capital në Konsorcium me ACP Axos Capital GmbH (SHBA, Gjermani); Elkos LLC (Kosovë); Geni Capital (Luksemburg); M1 International Limited (UK, Virgin Islands); Monaco Telecom International SAM(Monako); dhe Turkcell (Turqi). Procesi i privatizimit pritet të përfundojë deri në fund të vitit 2012.

Paralelisht me procesin e privatizimit, kompania ka finalizuar procesin e ndarjes së shërbimeve postare nga shërbimet e telekomit. Që nga data 1 Gusht 2012, që të dyja funksionojnë si të ndara.

2.6. Raporti mbi politikat monetare dhe fiskale

Sa i përket ndryshimeve legjislative që lidhen me politikat fiskale dhe tatimore, ligjet në vijim janë ndryshuar:

- Ligji Nr. 04/L-099, për ndryshimin dhe plotësimin e Akcizës dhe Kodit Doganor Nr. 03/1- 109 (data 01. 06. 2012);
- Miratimi i Ligjit Nr. 04/L-104 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-161 për Tatimin mbi të Ardhurat Personale (dekretuar më 15.06.2012 dhe efektiv nga data 1.07.2012);
- Miratimi i Ligjit Nr. 04/L-103 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-162 për Tatimin mbi të Ardhurat e Korporatës (dekretuar më 15.06.2012 dhe efektiv nga data 1.07.2012);
- Miratimi i Ligjit Nr. 04/L-108 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L197 mbi Vlerën e Shtuar në Taksa (dekretuar më 15.06.2012 edhe efektiv nga data 1.07.2012).

Këto ligje janë ndryshuar për të pasqyruar ndryshimet e normës së tatimit për bizneset profesionale dhe bizneset që ofrojnë shërbime dhe që kanë të ardhura vjetore bruto deri në 50,000€ nga 5% deri në 9% si dhe rregullimin e disa rasteve të veçanta të TVSH-së (të tilla si transporti ndërkombëtar i udhëtarëve, TVSH-ja e zbritur, mallrat nën marrëveshje të veçanta doganore, si dhe përcaktimi i vendit të furnizimit me mallra të tatueshme dhe shërbime të tatueshme) të cilat ndihmojnë më tej lidhur me këtë dhe me Direktivën e BE-së për TVSH-në.

Me qëllim të ruajtjes së stabilitetit fiskal, qeveria ka lënë pezull ndarjen e 20 milion € të shpenzimeve buxhetore deri sa të shpallet fituesi i ofertës për privatizimin e PTK-së.

Në fund të muajit Qershor, të dhënat tregojnë një bilanc primar pozitiv në llogarinë prej 25.26 milion € si rezultat i rritjes së shpejtë të të ardhurave dhe ekzekutimit të kujdesshëm të shpenzimeve. Qeveria do të mbajë një deficit primar jo më të lartë se 26 milion euro deri në fund të Gushtit, siç është përcaktuar nga Marrëveshja e Qëndrimit të FMN-së.

Të ardhurat e përgjithshme të qeverisë kanë arritur vlerën prej 649.76 milion € në gjysmën e parë të vitit duke shënuar një rritje prej 12% përgjatë të të njëjtës periudhë kohore me atë të vitit të kaluar. Të hyrat kufitare janë rritur për 1% krahasuar me periudhën e njëjtë në vitin e kaluar kështu duke arritur vlerën prej 354.01 milion € ndërsa të hyrat e mbledhura në vend janë rritur për 11% duke arritur vlerën prej 135.04 milion €. Gjithashtu një dividend prej 25 milion € është mbledhur gjatë kësaj periudhe.

Të ardhurat e përgjithshme të qeverisë janë rritur për 18% në gjysmën e parë të vitit, duke arritur shumën prej 625.6 milion €. Shpenzimet aktuale janë rritur për 14.6% përgjatë të të njëjtës periudhë kohore me atë të vitit të kaluar duke arritur një vlerë nominale prej 385.86 milion € ndërsa shpenzimet kapitale u rritën për 32% duke arritur shumën prej 224.84 milion € në terma nominale

a. Borxhi i përgjithshëm i Qeverisë

Stoku total i borxhit publik (të huaj dhe vendas) është afërsisht 350.8 milion €, nga të cilat 300.8 milion € është i huaj dhe se 50 milion € është borxh i brendshëm i lëshuar në formën e bonove. Qeveria nuk ka nxjerrë asnjë garanci për hua, megjithatë Ministria e Financave ka hyrë në një marrëveshje për nën kreditimin e fondeve për institucionet publike të tilla si ato për Transmisionin e Energjisë dhe Operatorin e Tregut (KOSTT) si dhe Kompaninë Rajonale të Ujësjellësit "Prishtina". Nuk ka borxhe të tjera.

2.7. Funkcionimi i tregjeve të produktit

a. Privatizimi

Shitja e asetëve përmes numrit 15 është mbajtur në këtë periudhë raportuese dhe ka përfshirë 34 asete. Nuk kishte oferta të dorëzua për 11 asete, 4 oferta u refuzuan dhe shitja e 19 asetëve u miratua. Një total prej 5.368 punonjësve kanë përfituar nga shpërndarja e 20% të të ardhurave në dispozicion nga shitja e ndërmarrjeve përkatëse.

Të ardhurat e mbledhura nga shitjet e privatizimit në periudhën mes 1 Qershor dhe 21 Gusht të vitit 2012 kanë arritur vlerën prej 2,330,937.99 milion €. Ndërsa shuma prej 20% e privatizimit që është shpërndarë për punëtorët ka arritur vlerën prej 6,486,974.73 milion €.

Shitja e projekteve individuale u zhvillua në Korrik: „Fabrika e Baterive Industriale“, dhe „Hotel Onix Banja e Pejës Spa“. Finalizimi i shitjes do të miratohet nga Bordi i Drejtorëve në Shtator.

b. Hyrja dhe Dalja e Biznesit

Një total prej 1,746 bizneseve janë regjistruar dhe 226 kanë pushuar së operuari gjatë kësaj periudhe raportuese. Tre qendra të tjera „Zyra Pritëse“ janë hapur përgjatë periudhës së njëjtë, duke sjellë numrin e përgjithshëm në 25 (qendrat e reja janë hapur në Lipjan, Graçanicë, dhe në komunën e Shtimes).

Gjithashtu, struktura e Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve ka ndryshuar si pjesë brendshme e Ristrukturimit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. Tani Agjencia ka një Drejtor të Përgjithshëm, një departament për çështje administrative dhe praktike të regjistrimit të biznesit, Një Sektor të Miratimit, një Sektor për Përpunimin e të Dhënave, si dhe një Sektor për Pengje/Seksion.

2.8. Tregjet Financiare

2.8.1 Sektori Bankar

Vlera totale e aseteve në Qershor 2012 ishte 3.5 miliardë € ose 72% e PBB-së. Struktura e aseteve të sektorit financiar vazhdon të dominohet nga asetet e bankave komerciale të cilat përbëjnë 74.8% të totalit të aseteve. Asetet e mbetura i përkasin fondeve pensionale (18.6% e aseteve), institucioneve Financiare (3.7% e aseteve), kompanive të sigurimit (3.2%) dhe institucionet financiare ndihmëse (0.03%).

Sektori bankar ka vazhduar të rritet me një vlerë vjetore të rritjes prej 6.2% me pasuritë e saj dhe ka arritur vlerën prej 2.65 miliardë € (ose 54% e PBB-së).

Struktura e pronësisë së sektorit bankar në Kosovë është i përbërë nga 6 banka të cilat janë në pronësi të huaj dhe 2 banka vendore. Në Qershor të vitit 2012, bankat e huaja arritën të menaxhojnë 89.2% të aseteve bankare në përgjithësi. Sistemi bankar karakterizohet relativisht me një shkallë të lartë të përqendrimit, e cila megjithatë vazhdon tendencën e saj rënëse. Shkalla e pjesëmarrjes së aseteve të tre bankave më të mëdha në asetet totale bankare ishte 72.1% në Qershor krahasuar me 74.5% në Qershor të vitit 2011. Indeksi Herfindahl-Hirschman (HHI) tregon se shkalla e përqendrimit ka rënë në 2,023 pikë në Qershor të vitit 2012 (krahasuar me 2,158 pikë në Qershor të vitit 2011).

Vlera e kredive të lëshuara nga sektori bankar deri në Qershor të vitit 2012 ka arritur në 1.77 miliardë € (36.2% e PBB-së), një rritje vjetore prej 9.3%. Kreditë familjare kishin një normë më të shpejtë të rritjes (13%) se sa kreditë për ndërmarrje (6.2%). Kreditë për ndërmarrje dominojnë strukturën e kredisë me 67% të totalit të kredive (Qershor 2012) me sektorin komercial që kryeson me 51.3% të kredive të ndjekura nga sektori industrial me 24.8%.

Proporcioni i Mjaftueshmërisë së Kapitalit ishte 17.2% në Qershor të vitit 2012 është rritur për 6.5% të kredive të përgjithshme (5.9% në 2011). Megjithatë, proporcioni i mbulimit të kredive me problem mbetet i kënaqshëm, duke qëndruar në 117.3% në Qershor (115.4% në Qershor të vitit 2011).

Norma mesatare e kredive për gjysmën e parë të vitit 2012 ka qëndruar në 13.7% (14.3 në periudhën e njëjtë të vitit 2011), ndërsa norma mesatare e interesit të depozitave ishte 3.4%. Fitimi neto i sistemit bankar në gjashtëmuorin e parë të vitit arriti vlerën prej 10.2 milion €, 31.2% më e ulët se e njëjta periudhë e vitit të kaluar. Kthimi Mesatar në Pasuri (ROAA) dhe Kthimi Mesatar i Kapitalit (ROAE) ka qëndruar në 0.4% dhe 4% respektivisht në Qershor të vitit 2012 (0.6% dhe 6.3% përgjatë periudhës së njëjtë në vitin 2011).

Divizioni i Letrave me Vlerë në kuadër të Bankës Qendrore të Kosovës gjatë periudhës Qershor-Gusht ka mbajtur 4 ankande për lëshimin e bonove të thesarit të qeverisë me afat maturimi brenda tre deri në gjashtë muaj.

2.8.2. Sektori Jo-Bankar

Që nga 30 Qershori 2012, ekzistojnë trembëdhjetë kompani që operojnë në treg. Dhjetë prej tyre nuk ofrojnë shërbime të cilat sigurojnë jetën dhe tre të tjera që ofrojnë shërbime për sigurimin e jetës.

Primet e shkruara bruto të industrisë së sigurimeve kanë vazhduar trendin e tyre pozitiv, duke u rritur për 4.15% gjatë gjysmës së parë të vitit.

Asetet likuide kanë mbetur dominuese në aktivitetet e përgjithshme të sigurimit me një pjesëmarrje prej 61% duke u pasuar nga asetet fikse me një pjesëmarrje prej 13,2%. Në krahasim me vitin e kaluar, kërkesat dhe llogaritë e arkëtueshme janë rritur për 26% të totalit të aseteve. Sa i përket detyrimeve, rezervat teknike përbëjnë pjesën më të madhe të 51.6% të totalit të detyrimeve.

a. Ndërrimet Strukturore në Ekonomi

Nuk ka zhvillime të regjistruara përgjatë periudhës së raportimit.

3. AFTËSIA PËR TË PËRBALLUAR DETYRIMET QË RRJEDHIN NGA MSA

3.1. Dialogu Politik

Nuk ka zhvillime të regjistruara përgjatë periudhës së raportimit.

3.2. Bashkëpunimi Rajonal

a. Çështjet rajonale dhe detyrimet ndërkombëtare

Në takimin vjetor të KBR-së të mbajtur në Beograd më 13.06.2012 Kosova u përfaqësua nga Koordinatori Kombëtar në KBR.

Në takimin e pestë të CEFTA-s të zëvendësministrave të mbajtur në Tiranë më 20 Qershor, Kosova u përfaqësua nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë.

Takimi i fundit i KIBP-së i cili është mbajtur më 14 dhe 15.06.2012 në Vjenë, Austri. Komiteti Drejtues ka shqyrtuar projektet e dorëzuara në kuadër të raundit të 7 të aplikimeve. Në takimin e Komitetit Drejtues të KIBP-së, Kosova ka qenë e përfaqësuar nga Zyra e Kryeministrit dhe Ministria e Integritimeve Evropiane.

Në raundin e 7-të Kosova ka aplikuar me pesë projekte kombëtare, nga të cilat katër janë miratuar: dy në sektorin e energjisë dhe dy në sektorin e mjedisit. Lista e projekteve të miratuara përfshin: Masat e Efikasitetit të Energjisë në Ndërtesat Publike në Nivel Lokal, Masat e Efikasitetit të Energjisë në Ndërtesat Publike në Nivel Qendror, Studimi i Fizibilitetit për Mbrojtjen e Kanalit të Ibër-Lepenc, dhe Përmirësimi i Menaxhimit të Mbeturinave. Projektet e miratuara mbështeten nga Banka Botërore dhe Banka Gjermane për Zhvillim (KfW). Grandet do të sigurohen nga Fondi i Përbashkët Evropian për Ballkanin Perëndimor (FPEBP).

3.3. Lëvizja e Lirë e Mallrave dhe e Kapitalit

a. Akreditimi

Gjatë kësaj periudhe, këto politika janë shqyrtuar: nën-kontraktimi i vlerësimeve DAK-PO-006, labororët dhe testet e zotësisë, DAK-PO-007, gjurmueshmëria e matjeve, DAK-PO-008 dhe neutraliteti i konfliktit të interesit dhe përfshirjes së palëve të interesuara, DAK-PO-009.

Gjatë kësaj periudhe DAK ka vizituar, mbikëqyrur dhe vlerësuar këto laboratorë: Agjencia e ushqimit dhe veterinarisë, Laboratori për diagnozën dhe monitorimin e sëmundjeve, Laboratori për kontrollin e cilësisë, Laboratori i mikrobiologjisë ushqimore, Laboratori i Kimisë dhe Mbetjeve Veterinare.

Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik, Laboratori i mbikëqyrjes për analizën fiziko-kimike të ujit të pijshëm dhe ujërave rekreativ, Laboratori i kontrollit të cilësisë, Laboratori i mikrobiologjisë së ujërave dhe testimit të ushqimit..

DAK ka rekrutuar një punëtor si zyrtar për akreditimin e laboratorëve testues dhe kalibrues. Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve më 17.07.2012, DAK ka zhvilluar një trajnim të quajtur "Kërkesat e Përgjithshme për Kompetencat e laboratorëve testues dhe kalibrues" ISO/IEC 17025: 2007. Në trajnimin kanë qenë 13 pjesëmarrës, të cilët janë njerëz përgjegjës që punojnë në laboratorë si ekspertë të fushave të ndryshme.

b. Standardizimi

Në kontekstin e miratimit të standardeve evropiane EN si Standarde Kosovare, gjatë kësaj periudhe kohore janë miratuar 262 standarde të reja në fushën e Vajit dhe gazit, Pajisjeve mbrojtëse personale, Shërbimeve postare dhe të telekomunikacionit, Përpunimit të drurit dhe Shëndetësore. Gjithsej numri i standardeve të zhvendosura ka arritur në 4262.

c. Metrologji

Në Qershor të vitit 2012, është miratuar Rregullorja e Brendshme e MTI-së, ku funksioni i metrologjisë është vendosur nga Departamenti i Agjencisë, i cili në strukturën e tij përmban: metrologjinë ligjore, metrologjinë shkenco-industriale, mbikëqyrjen e metrologjisë, dhe sektorin e metaleve të çmuara.

UA Nr .08/2012 është miratuar më 18.06.2012, lidhur me pagesën maksimale për Shërbimet Metrologjie.

Gjatë kësaj periudhe kohore, tre inxhinierë të makinerisë janë rekrutuar, të cilët kanë filluar punën nga data 01.08.2012. Ata do të angazhohen dhe trajnohen për krijimin e sektorit për mbikëqyrje metrologjie.

Më 17.07.2012, është nënshkruar Memorandumi i Bashkëpunimit me Institutin e Metrologjisë TUBITAK-UME nga Turqia dhe një plan veprimi për zbatimin e veprimeve që dalin nga ky Memorandum është përgatitur.

Kontrolli i instrumenteve për masat ligjore është kryer, dhe është përdor për qarkullim publik:

- Verifikimi dhe vulosja e pajisjeve matëse të rrjedhjes (pikat e shitjes së karburantit) 59 pika të shitjes;
- Verifikimi dhe nënshkrimi i masave elektronike (lloje të ndryshme) duke përfshirë 59000 – copë;
- Verifikimi dhe vulosja e llojeve të ndryshme të peshoreve, duke përfshirë 77 copë;
- Verifikimi i metrit në gjatësi, duke përfshirë 25 copë;
- Kalibrimi dhe lëshimi i certifikatave për peshore të ndryshme, duke përfshirë 23 copë.

Kontrollimi i cilësisë së punës së metaleve të çmuara; 18 subjekte argjendarësh, ku ka pasur 50 analiza preliminare të realizuara, ndërsa 100 copë pllaka të arit janë mbyllur (703.04 g) dhe 204 copë të punimeve prej argjendit (1679.45 g).

3.4 Lëvizja e personave, shërbimeve dhe e drejta e themelimit

3.4.1. Lëvizja e njerëzve

Kapitali Njerëzor: Katërqind (400) punëkërkuar kanë përfituar nga trajnimi për punë dhe programi i praktikës pjesë kjo e „Programi Aktiv i Tregut të Punës për Gjenerimin e Punësimit“. Dyqind e nëntëdhjetë e katër persona janë punësuar gjatë periudhës Qershor-Gusht përmes implementimit të projektit „Beautiful Kosovo“. Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve ka akredituar të gjitha shtatë Qendrat për Kualifikim Profesional (Prishtina, Prizren, Peja, Gjakova, Ferizaj, Mitrovica, dhe Gjilan) për periudhën 2012-2015 duke licencuar profilet profesionale të fazës së parë.

3.4.2. Lëvizja e Shërbimeve

Kapitali Fizik: Sa i përket infrastrukturës së transportit, segmenti 4b i autostradës R7 është përfunduar duke e bërë gjatësinë e përgjithshme të autostradës operative dhe të hapur për trafikun deri në 42 km.

Reforma dhe Liberalizimi i industrive të rrjetit

Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) më 18 Korrik 2012 ka miratuar modifikimin/harmonizimin e licencës për energji elektrike në mënyrë që të përshtatet me legjislacionin primar të sektorit të energjisë.

ZRRE ka miratuar tarifën e reja të energjisë elektrike (20.06.2012) të cilat janë 8.9% më të larta se tarifën e mëparshme.

Sa i përket industrisë së telekomunikacionit, Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit gjatë periudhës raportuese ka lëshuar tre licenca për ofruesit e shërbimeve të internetit (ISP): shërbimet e internetit në nivel kombëtar, shërbimet e internetit në nivel rajonal, si dhe shërbimet me vlerë të shtuar. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe raportuese, Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit (ART) ka lëshuar 9 vendime rregullative (Shih seksionin mbi Shoqërinë Informativë dhe Media për listën e detajuar të vendimeve).

Deri më 01.06.2012, ka pasur një rritje të konsiderueshme në volumin (12%) si dhe në vlerën (22%) e të gjitha transaksioneve ndër-bankare, efikasitetit në kryerjen e sigurte të të gjitha transaksioneve qeveritare, dhe në menaxhimin efikas të rrezikut operacional dhe financiar në sistemin e pagesave.

Sistemi për raportim elektronik i quajtur “Regjistri i mbajtësve të Llogarive Bankare” është funksionalizuar nga Banka Qendrore e Kosovës për herë të parë këtë Qershor.

Gjatë periudhës së raportimit, ka pasur statistika në fushën e statistikave monetare-financiare në lidhje me finalizimin dhe fillimin e publikimit të statistikave për institucionet mikro-financiare dhe agjencitë e tjera që përdorin transferimin e parave.

Kjo është realizuar pas një fillimi të suksesshëm të një serie të projekteve statistikore të tilla si: Raporti Statistikor mbi Institucionet Mikro-Financiare, Raporti mbi Normat e Interesit (në institucione mikro-financiare), si dhe Raporti Statistikor mbi Transferimin e të keshit (cash) (në agjenci për transferimin e keshit).

Lidhur me ngritjen e kapaciteteve, gjatë periudhës raportuese, BQK-ja ka punësuar 4 punëtor të rinj: dy në departamentin e Mbikëqyrjes së Sigurimeve, një në departamentin e Licencimit dhe Rregulloreve, dhe një në departamentin e Statistikave. Një numër prej 30 punëtorëve kanë ndjekur trajnime profesionale në vendet e huaja në tema të tilla si “Tregjet Financiare dhe Instrumentet e Reja Financiare”, “Mbikëqyrja e fokusuar në rrezik dhe vlerësimin e rrezikut”, “Projektimi i strategjisë për menaxhimin e borxhit publik”.

3.4.2.1. Kontrolli Financiar

Sektori i Auditorit të Brendshëm ka rekrutuar një auditor të ri duke çuar numrin e përgjithshëm të auditorëve të brendshëm në 136. Një total prej 52 raporteve është pranuar dhe analizuar nga Njësitë e Auditimit të Brendshëm në tremujorin e dytë të vitit 2012.

Sa i përket zhvillimeve institucionale të auditimit të jashtëm, Auditori Gjeneral ka caktuar një Zëvendës Auditor Gjeneral, i cili përveç përgjegjësive të zëvendësit do të ketë një rol të veçantë në zhvillimin e mëtejshëm të performancës së auditorëve. Gjithashtu, gjashtë auditorë zëvendësues janë punësuar në Qershor, të vitit 2012.

Në periudhën raportuese, Zyra e Auditorit Gjeneral ka kryer:

- 88 Auditime të rregullsisë (të gjitha ministritë, të gjitha komunat, institucionet e pavarura);
- 8 raporte të menaxhimit të auditimit;
- 4 Auditime të Fondit të Donatorëve.

3.4.3. Mbrojtja e Konsumatorëve

Nuk ka zhvillime të regjistruara përgjatë periudhës së raportimit.

3.4.4. Tregtia

a. Integrimi i Tregtisë

Në gjysmën e parë të vitit 2012, importet nga BE-ja janë rritur për 9% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar e cila përbënte 38% të totalit të importeve të Kosovës. Vlera nominale e importeve të BE-së në Kosovë në këtë periudhë ishte 428 milion €. Shtetet më të mëdha importuese janë Gjermania me 11.6% të vlerës së përgjithshme të importeve ose shprehur nominalisht me 130 milion € dhe Italia me një vlerë nominale të importeve prej 93 milion € ose 8.4% të vlerës së përgjithshme të importeve të Kosovës. Importet nga Italia janë rritur me 57.7% në të njëjtën periudhë.

Eksportet e Kosovës në BE kanë rënë për 28.8% në të njëjtën periudhë duke arritur një vlerë nominale prej 55 milion € ose 41.6% të eksporteve të përgjithshme të Kosovës. Italia dhe Gjermania janë partnerët kryesorë të Kosovës. Eksportet me Italinë përbëjnë 71% të eksporteve të Kosovës në BE dhe 29.8% të eksporteve të përgjithshme të Kosovës.

Shkëmbimi tregtar i Kosovës me CEFTA-n ka arritur shumë prej 419 milion €, duke shënuar një rënie prej 6.5%.

Importet nga CEFTA përbëjnë 33% të importeve të përgjithshme ose nominalisht një vlerë prej 419 milion €. Ka pasur një rënie prej 6.5% të importeve të CEFTA-s në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2011.

Eksportet e Kosovës me vendet e CEFTA-s gjatë të njëjtës periudhë kanë arritur një vlerë prej 48 milion € që përbën

36.5% të eksporteve të përgjithshme. Eksportet e tilla kanë pasur një trend pozitiv në gjysmën e parë të vitit 2012 me një rritje prej 22.7% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2011.

3.4.5. Ligji i Kompanive

Nuk ka zhvillime të regjistruara përgjatë periudhës së raportimit.

3.4.6. Tregtia në Shërbime

Nuk ka zhvillime të regjistruara përgjatë periudhës së raportimit.

3.4.6.1. Shërbimet Postare

Nuk ka zhvillime të regjistruara përgjatë periudhës së raportimit.

3.5. Konkurrenca

Nuk ka zhvillime të regjistruara përgjatë periudhës së raportimit.

3.6. Të drejtat mbi pronësinë intelektuale, industriale dhe komerciale

3.6.1. Të drejtat mbi pronësinë industriale

UA në vijim janë miratuar:

- UA Nr. 09/2012 mbi kompetencat, mandatin, dhe punën e Komisionit për Ankesa në Zyrën për Pronësi Industriale e nënshkruar më 19.06.2012.
- UA Nr. 10/2012 mbi procedurat e regjistrimit të Patentave e nënshkruar më 11.07.2012.
- UA Nr. 11/2012 mbi regjistrimin e Dizajnit Industrial e nënshkruar më 14.08.2012.
- UA Nr. 12/2012 mbi tarifatat administrative për regjistrimin e objekteve të pronës industriale e nënshkruar më 14.08.2012.
- UA Nr. 13/2012 mbi regjistrimin e Markës Tregtare e nënshkruar më 14.08.2012.

